

LANDWAYS INTERNATIONAL sh.p.k
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

PËRMBAJTJA:

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCËS	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	6
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	7 – 22

Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2018

	Shënime	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
AKTIVE			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	71,195,805	47,807,593
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	36,385,509	125,230,793
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	25,116,236	15,938,830
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	1,817,515	5,711,829
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	8	9,063,219	30,887,249
Garanci	9	934,010	-
Huadhënie afatshkurtër	10	535,696,543	225,291,916
Totali i aktiveve afatshkurtra		680,208,837	450,868,210
Aktivët afatgjatë			
Aktive afatgjatë materiale	11	23,819,614	26,331,322
Aktive afatgjatë jomateriale	12	945,000	1,260,000
Totali i aktiveve afatgjatë		24,764,614	27,591,322
Totali i aktiveve		704,973,451	478,459,532
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	13	63,749,614	25,732,904
Llogari të pagueshme tregtare	14	402,857,677	304,039,408
Detyrime tatimore	15	6,086,902	5,545,401
Parapagime të arkëtuara	16	5,260,805	101,099
Të tjera detyrime	17	76,050	1,562,348
Totali i detyrimeve afatshkurtra		478,031,048	336,981,160
Detyrime afatgjatë			
Hua afatgjatë	18	53,709,334	13,419,371
Totali i detyrimeve afatgjatë		53,709,334	13,419,371
Totali i detyrimeve		531,740,382	350,400,531
Kapitali			
Kapitali i nënshkruar		100,000	100,000
Rezerva të tjera		127,959,001	92,235,398
Fitimi i ushtrimit		45,174,068	35,723,603
Totali i kapitalit	19	173,233,069	128,059,001
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		704,973,451	478,459,532

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	20	3,633,779,322	2,591,232,887
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	21	20,643,126	1,601,382
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe të tjera shpenzime		(3,551,498,451)	(2,517,833,324)
1) Lënda e parë, material të konsumueshme	22	(3,515,814,445)	(2,496,727,567)
2) Të tjera shpenzime	23	(35,684,006)	(21,105,757)
Shpenzime të personelit	24	(40,080,567)	(24,268,703)
1) Paga dhe shpërblime		(34,574,815)	(21,028,996)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore		(5,505,752)	(3,239,707)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	25	(6,430,306)	(6,874,948)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	26	(172,588)	(66,937)
Shpenzime financiare	27	(3,064,117)	(1,750,776)
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		(3,064,117)	(3,677,869)
2) Shpenzime të tjera financiare		-	1,927,093
Fitimi/humbja para tatimit		53,176,419	42,039,581
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(8,002,351)	(6,315,978)
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	28	(8,002,351)	(6,315,978)
Fitimi/humbja e vitit		45,174,068	35,723,603
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		45,174,068	35,723,603

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Landways International sh.p.k


(Vlerat janë në Lekë)


Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva të tjera	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 1 janar 2017	100,000	65,163,681	27,071,717	92,335,398
Fitim/humbja e vitit			35,723,603	35,723,603
Transferim në rezerva të tjera		27,071,717	(27,071,717)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2017	100,000	92,235,398	35,723,603	128,059,001
Fitim/humbja e vitit			45,174,068	45,174,068
Transferim në rezerva të tjera		35,723,603	(35,723,603)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018	100,000	127,959,001	45,174,068	173,233,069

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 janë aprovuar nga administratori i Landways International sh.p.k.më _____ dhe janë firmosur si më poshtë.


Eliona Kerci
Hartues


Gazmend Haxhia
Administrator



Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	45,174,068	35,723,603
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	6,430,306	6,874,948
Diferenca këmbimi jo nga aktivitetet operative	-	(1,927,093)
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	83,562,193	(119,260,016)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	97,873,472	174,933,204
Rënie/(rritje) në parapagime dhe shpenzime të shtyra	21,824,030	(30,552,049)
Rritje/(rënie) në parapagime të arkëtuara	5,159,706	-
Rritje/(rënie) në garanci bankare	(934,010)	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	259,089,765	65,792,597
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(3,603,599)	(2,814,377)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(3,603,599)	(2,814,377)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Hua të paguara/arkëtuara	(232,097,954)	(32,571,684)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	(232,097,954)	(32,571,684)
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	23,388,212	30,406,536
Mjetet monetare në fillim të periudhës	47,807,593	17,401,057
Mjetet monetare në fund të periudhës	71,195,805	47,807,593

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "Landways International" sh.p.k është regjistruar në Regjistrin e Shoqërive me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në datë 07.11.2015.

Objekti kryesor i Shoqërisë në treg është shitja e biletave të avionit, tragetit dhe trenit në të gjitha destinacionet që menaxhojnë shoqëritë përkatëse, udhëtimet turistike në të gjitha destinacionet turistike në Shqipëri dhe në botë, paketat turistike etj.

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100,000 lekë i cili zotërohet nga z. Gazmend Haxhia, ortaku i vetëm i Shoqërisë. Adresa e Shoqërisë është: rruga "Themistokli Gërmenji", pranë zonës së TVSH, Shkalla 1, Kati 1, Tiranë. Administrator i Shoqërisë është z.Gazmend Haxhia.

Shoqëria në fund të periudhës ushtrimore ka 75 punonjës (2017: 56).

Shoqëria është e regjistruar pranë degës së Tatim Taksave në Tiranë me NIPT K61422004L.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritsshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5. Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarjeje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin „Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 i është detajuar si më poshtë:

<u>Kursi i këmbimit</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
EUR/LEK	123.42	132.95
USD/ LEK	107.82	111.10

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerrret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivitet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.


Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve të ndërtuara vetë përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitet në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitet. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitet kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivitet afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.



3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2018 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25%
Mobilje dhe orendi	Vlera e mbetur	20%
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20%

Toka nuk amortizohet.

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Aktivitet afatgjata jomateriale

Një aktiv jo-material njihet nëqoftëse, e vetëm nëqoftëse është e mundshme që përfitimet e pritshme ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij aktiviteti do të rrjedhin tek njësi ekonomike; dhe kosto e aktivitetit mund të matet me besueshmëri.

Një njësi ekonomike vlerëson mundësinë e përfitimeve të pritshme ekonomike në të ardhmen duke përdorur supozime të arsyeshme dhe të mbështetura që përfaqësojnë vlerësimin më të mirë të drejtimit të kompletit të kushteve ekonomike që do të ekzistojnë gjatë jetës së dobishme të aktivitetit.

Njësi ekonomike përdor gjykimin për të vlerësuar shkallën e sigurisë bashkëngjitur flukseve të përfitimeve ekonomike në të ardhmen që i atribuohen përdorimit të aktivitetit mbi bazën e evidencës së disponueshme në kohën e njohjes fillestare, duke i dhënë më shumë rëndësi evidencës nga të tretët. Një aktiv jo-material matet fillimisht me koston.

Mbajtja e mëpasshme

Mbas njohjes fillestare, një aktiv jo-material mbartet me koston e tij minus çdo amortizim të akumuluar dhe çdo humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Aktivitetet jo-materiale amortizohen me normën 10% mbi koston historike.

3.6. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.7 Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.8 Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka qira operative.

3.9 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.10 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2018 është 15% (2017: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka njohur tatim të shtyrë për humbjet e mbartura fiskale.

3.11 Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.



3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.12 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.13 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.14 Aktivitetet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare


Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Mjete monetare në bankë	21,658,111	6,277,447
Në Lekë	7,528,808	2,868,649
Në monedhë	14,129,303	3,408,798
Mjete monetare në arkë	49,537,694	41,530,146
Në Lekë	40,704,018	33,384,014
Në monedhë	8,833,676	8,146,132
	71,195,805	47,807,593

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Klientë	36,385,509	125,230,793
	36,385,509	125,230,793



13

Landways International sh.p.k
 Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
 (Vlerat janë në Lekë)

6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	25,116,236	15,938,830
	<u>25,116,236</u>	<u>15,938,830</u>

7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë e tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
TVSH për t'u arkëtuar-Leasing	1,817,515	2,844,314
Kërkesa për sigurimet shoqërore	-	10,681
Të tjera kërkesa për tu arkëtuar	-	2,856,834
	<u>1,817,515</u>	<u>5,711,829</u>

8. Parapagime dhe shpenzime të shtyra

Parapagime dhe shpenzime të shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Parapagime të dhëna	2,029,887	3,113,786
Shpenzime të periudhave të ardhshme	7,033,332	27,773,463
	<u>9,063,219</u>	<u>30,887,249</u>

9. Garanci


Garancitë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Garanci bankare për IATA	934,010	-
	<u>934,010</u>	<u>-</u>

10. Huadhënie afatshkurtër

Huadhënie afatshkurtër më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Huadhënie afatshkurtër	535,696,543	225,291,916
	<u>535,696,543</u>	<u>225,291,916</u>



Landways International sh.p.k
 Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
 (Vlerat janë në Lekë)

11. Aktive afatgjata materiale	Kompjutera	Mobilje e pajisje zyre	Mjete transporti	Të tjera	Totali
Kosto					
Gjendja më 1 janar 2017	11,443,496	2,167,925	25,099,675	-	38,711,096
Shtesa	1,303,588	144,000	-	1,366,789	2,814,377
Gjendja më 31 dhjetor 2017	12,747,084	2,311,925	25,099,675	1,366,789	41,525,473
Shtesa	2,219,795	1,383,803	-	-	3,603,598
Gjendja më 31 dhjetor 2018	14,966,879	3,695,728	25,099,675	1,366,789	45,129,071
Amortizimi i akumuluar					
Gjendja më 1 janar 2017	4,803,449	902,459	2,928,295	-	8,634,203
Amortizimi i vitit	1,822,434	257,678	4,434,276	45,560	6,559,948
Gjendja më 31 dhjetor 2017	6,625,883	1,160,137	7,362,571	45,560	15,194,151
Amortizimi i vitit	1,876,218	434,962	3,804,126	-	6,115,306
Gjendja më 31 dhjetor 2018	8,502,101	1,595,099	11,166,697	45,560	21,309,457
Vlera neto kontabël					
Gjendja më 31 dhjetor 2017	6,121,201	1,151,788	17,737,104	1,321,229	26,331,322
Gjendja më 31 dhjetor 2018	6,464,778	2,100,629	13,932,978	1,321,229	23,819,614

Landways International sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
(Vlerat janë në Lekë)

12. Aktive afatgjata jomateriale

Me kosto	31 dhjetor 2018	Total
Gjendja më 1 janar 2017	3,150,000	3,150,000
Shtesa	-	-
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	3,150,000	3,150,000
Shtesa	-	-
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	3,150,000	3,150,000
Zhvlërësimi akumuluar		
Gjendja më 1 janar 2017	1,575,000	1,575,000
Zhvlërësimi i vitit	315,000	315,000
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	1,890,000	1,890,000
Zhvlërësimi i vitit	315,000	315,000
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	2,205,000	2,205,000
Gjendja neto më 31 dhjetor 2017	1,260,000	1,260,000
Gjendja neto më 31 dhjetor 2018	945,000	945,000

13. Hua afatshkurtër

Llogaria e huasë aftashkurtër më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Kartë krediti	5,593,611	2,929,867
Overdraft	30,849,329	-
Huamarrje afatshkurtër	27,306,674	22,803,037
	63,749,614	25,732,904

14. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Llogari të pagueshme tregtare	402,857,677	304,039,408
	402,857,677	304,039,408

15. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Detyrime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	854,528	457,698
Detyrime për tatimin mbi të ardhurat personale	123,162	43,134
Tatim fitimi	2,062,267	1,704,825
Tvsh për tu paguar	2,994,928	3,264,154
Tatimi në burim	52,017	66,400
Të tjera detyrime për tu paguar dhe për tu kthyer	-	9,190
	<u>6,086,902</u>	<u>5,545,401</u>

16. Parapagimet dhe të ardhura të shtyra

Parapagimet dhe të ardhurat e shtyra më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Parapagime të marra nga klientët	996,722	101,099
Të ardhura të shtyra	4,264,083	-
	<u>5,260,805</u>	<u>101,099</u>

17. Të tjera detyrime

Të tjera detyrime më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Paga të pagueshme	76,050	1,562,348
	<u>76,050</u>	<u>1,562,348</u>

18. Hua afatgjatë

Llogaria hua afatgjatë më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Hua afatgjatë	53,709,334	13,419,371
	<u>53,709,334</u>	<u>13,419,371</u>

19. Kapitali

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 LEK i zotëruar 100% nga ortaku i Landways International sh.p.k, Z. Gazmend Haxhia.

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Numri i kuotave	100	100
Vlera nominale	1,000	1,000
Kapitali themeltar	<u>100,000</u>	<u>100,000</u>

Shuma prej 127,959,001 Lekë përfaqëson rezerva të tjera (2017: 92,235,398 Lekë).

Shuma prej 45,174,068 Lekë përfaqëson fitimin e ushtrimit (2017: 35,723,603 Lekë).

20. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Të ardhura nga organizim për ture për grupe	3,259,960,945	2,318,768,976
Të ardhura nga konferenca për evente	164,656,705	129,910,214
Të ardhura nga shitje bileta udhëtimi	125,756,472	45,102,470
Të ardhura nga transporti	787,288	1,066,144
Të ardhura nga shërbime akomodimi	8,293,480	9,430,513
Të ardhura nga qiraja	15,183,527	22,798,747
Të ardhura nga Crociere	56,515,180	62,805,341
Të ardhura të tjera	2,625,725	1,350,482
	<u>3,633,779,322</u>	<u>2,591,232,887</u>

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së

	<u>31 dhjetor 2018</u>
Rakordimi i të ardhurave me FDP-në	
Qarkullim i tatueshëm	3,638,043,405
Sipas Kontabilitetit	3,633,779,322
Shtohen të ardhura të periudhave të ardhshme	4,264,083
Diferenca	<u>-</u>

21. Të ardhurat të tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Humbje nga këmbimet valutore nga aktiviteti operativ	(19,739,762)	(6,184,563)
Fitim nga këmbimet valutore nga aktiviteti operativ	40,382,888	7,785,945
	<u>20,643,126</u>	<u>1,601,382</u>

22. Lëndë e parë, materiale të konsumueshme

Në këtë zë paraqiten kostoja e shërbimeve të ofruara që lidhen me veprimtarinë e shfrytëzimit. Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqitet si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Akomodime	17,230,590	15,775,440
Shpenzime për grupe	3,141,543,450	2,230,639,898
Shpenzime transporti	3,712,639	1,441,319
Shpenzime për udhëtime diteta	81,999,189	53,715,466
Shpenzime për bileta	147,158,907	64,967,545
Shpenzime qiraje	2,500,000	891,334
Shpenzime eventesh	87,636,591	91,362,633
Shpenzime të tjera direkte	-	29,800
Shpenzime Crociere	34,033,079	37,904,132
	<u>3,515,814,445</u>	<u>2,496,727,567</u>

Landways International sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
(Vlerat janë në Lekë)

23. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Shpenzime energjie	233,833	225,327
Shpenzime qiraje pajisje	5,567,609	4,922,908
Kancelari	1,180,485	990,826
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	2,408,921	1,894,559
Shpenzime për kredinë	45,444	-
Komisione bankare	11,296,638	5,529,706
Taksa doganore dhe bashkiake	279,575	435,629
Shpenzime të tjera	2,174,889	612,080
Mirëmbajtje	1,405,021	1,222,834
Shpenzime doganore	16,975	188,219
Shpenzime trajnimi	10,653	668,845
shpenzime konsulence dhe auditimi	9,893,976	2,704,203
Shpenzime pritje dhe përfaqësimi	902,901	674,768
Shpenzime panairi	-	591,942
Shpenzime noteriale	93,833	315,745
Sigurime	173,253	128,166
	<u>35,684,006</u>	<u>21,105,757</u>

24. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Shpenzime paga	34,574,815	21,028,996
Shpenzime per sigurime shoqerore	5,505,752	3,239,707
	<u>40,080,567</u>	<u>24,268,703</u>

Shoqëria në fund të periudhës ushtrimore ka 75 punonjës (2017: 56).

25. Shpenzime konsumi dhe amortizimi

Shpenzimet e konsumit dhe amortizimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Shpenzime amortizimi	6,430,306	6,874,948
	<u>6,430,306</u>	<u>6,874,948</u>

26. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjobat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Gjoha	172,588	66,937
	<u>172,588</u>	<u>66,937</u>

27. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit, të ardhurat nga këmbimet valutore dhe shpenzime të tjera financiare që lidhen me aktivitetin financiar të shoqërisë. Ky zë paraqitet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Shpenzime financiare	3,064,117	3,677,869
Shpenzime të tjera financiare	-	(1,927,093)
	<u>3,064,117</u>	<u>1,750,776</u>

28. Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
<i>Fitimi para tatimit</i>	53,176,419	42,039,581
Total shpenzime të panjohura	172,588	66,937
Penalite, gjoba e dëmshpërblime	172,588	66,937
<i>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</i>	<u>53,349,007</u>	<u>42,106,518</u>
<i>Tatim fitimi @15%</i>	8,002,351	6,315,978
	<u>45,174,068</u>	<u>35,723,603</u>

29. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2018		31 dhjetor 2017	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të arkëtueshme	Të pagueshme
A.S.G	-	-	-	-
Ortaku	25,116,236	-	15,938,830	-
	25,116,236	-	15,938,830	-

Transaksionet me palët e lidhura më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2018		31 dhjetor 2017	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
A.S.G	-	121,541,650	-	121,468,844
	-	121,541,650	-	121,468,844

30. Angazhime dhe pasiguri*Çështje gjyqësore*

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palët e treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 dhjetor 2018 shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kerkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në menyrë të besueshme.

31. Ngjarje pas bilancit

Më datë 17.01.2019 shoqëria ka ndryshuar emrin tregtar nga Albanian Experience sh.p.k në Landways International sh.p.k.